



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr.____ Prot.

Datë : 04/05/ 2009

VENDIM

Nr.109, datë 04.05.2009

**“Për
rekomandim mbi rishikimin e pikës 1 të Vendimit të Këshillit
Administrativ të ISKSH-së Nr.50, datë 12.12.2008”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar
Rezana	KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04/05 /2009, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

- “Vlerësim i Vendimit të Këshillit Administrativ të ISKSH-së Nr. 50 datë 12.12.2008 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, farmacive dhe agjencive farmaceutike, depove importuese, distributoreve të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së – QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2009”

Baza ligjore:

- Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, gërma “f”, neni 69 pika 1, gërma (a) dhe neni 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Ankesës Nr.23/01, datë 23.01.2009 të Sindikatës së Pavarur të Farmacistëve të Rrjetit të Hapur ;
- Relacionit të Sekretares së Përgjithshme;
- Pretendimeve të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor në seancën konsultative me Komisionin e Konkurrencës me datë 23 prill 2009;

VËREN SE:

1. Vendimi Nr.50 datë 12.12.2008 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, Farmacive dhe Agjencive farmaceutike, depove importuese, distributore të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së

– QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2009”, në pikën 1 shprehet: “Miratimin e kontratës tip F/2009 sipas formatit dhe përmbajtjes që i bashkëngjitet këtij vendimi, me ndryshimin e mëposhtëm të propozuar nga KA “Vendosja e vlerës limit të rimbursimit mujor të çmimit të barnave, në farmaci dhe A/farmaceutike të kontraktuara në masën 1 500 000 lekë. Mbi këtë limit farmacistë, a/farmaceutike mund ti rimbursohet deri në 2% të kësaj vlere”.

Nga seanca konsultative me përfaqësues të ISKSH-se rezultoi se kriteri i shprehur në pikën 1 të Vendimit Nr.50 datë 12.12.2008 ka patur si qëllim mbrojtjen e konkurrencës së ndershme në treg.

2. Në vlerësim të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, në nenet 69, pika 1/a dhe 70, Vendimi nr.50 datë 12.12.2008 i ISKSH-se, sjell kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregimin e barnave të rimbursueshme.
3. Ky kufizim sasior në masën prej 1.500.000 lekë në muaj, plus 2%, i parashikuar në pikën 12 të këtij kapitulli, sjell një kufizim të detyrimeve specifike (pika 5) në kontratën e farmaceutike, pasi në rastet e plotësimit të limitit të caktuar, farmacia nuk do të ofrojë shërbimin e dhënies së barnave, duke kufizuar në këtë mënyrë zgjedhjen e konsumatorit.
4. Këshilli Administrativ dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, duhet që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që ndikon në konkurrencën në treg, në kuptim të neneve 69 dhe 70 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe sipas udhëzuesit “Për vlerësimin e pasojave të legjislativitetit mbi konkurrencën”, miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 68, datë 24.12.2007.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 24 gërma (f), 69 pika 1, gërma (a) dhe nenit 70, të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit;

VENDOSI:

- 1- T’i rekomandojë Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, rishikimin e pikës 1 të Vendimit të tij nr.50, datë 12.12.2008 “Për miratimin e kontratave tip midis ISKSH, Farmaceutike dhe Agjencive farmaceutike, depove importuese, distributore të barnave si dhe kontratën trepalëshe ndërmjet ISKSH-së – QSUT-së – Depove të Barnave për vitin 2009”;
- 2- Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm t’ua komunikojë këtë vendim organeve përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Datë 4/05/2009

MENDIMI I PAKICËS

Mendoj që që pjesën konstatuese të vendimit dhe që njëkohësisht përbën edhe mendimin e shumicës vendimmarrëse nuk janë marrë në konsideratë disa argumenta të rëndësishëm të cilët e ndryshojnë bazën arsyetuese të tij dhe në këtë mënyrë mund të ndikojnë edhe në dispozitivin e tij.

-Nje element shume i rëndësishem i shqyrtimit nga ana e Komisionit që nuk është paraqitur ne vendim, është informacioni i “Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë, dhe kërkesat e komunitetit te farmacive per vendosjen e limitit të rimbursimit.

-Përsa u përket pikave 1 dhe 4 të pjesës konstatuese të Vendimit, i gjej ato në përputhje, si të dokumentacionit të mbledhur nga Sekretariati i Konkurrencës për këtë qëllim, ashtu edhe të detyrimeve ligjore që kanë organet e tjera të administratës qëndrore dhe vendore për t'i kërkuar vlerësim Autoritetit të Konkurrencës në lidhje projekt-aktet e tyre.

-Përsa i përket pikës 2 të konstatimeve gjykoj se nuk jemi përpara rastit të kufizimeve sasiore për hyrjen në treg që parasheh Ligji nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Në rastin më konkret nuk bëhet fjalë për kufizim të sasisë së barnave të rimbursueshme në treg, por për rimbursim të këtyre barnave deri në një masë të caktuar nga shteti; masë e cila lidhet dhe me gjendjen, të drejtën dhe buxhetin e ISKSH për këtë funksion ekskluziv të saj.

Limiti prej 1.500.000 lekë në muaj plus 2%, i parashikuar në pikën 12 të kësaj kontrate, nuk sjell një kufizim të detyrimeve specifike pasi në rastet e plotësimit të limitit të caktuar, kjo nuk është praktikë e panjohur, madje do të shtoja, shumë e njohur sidomos në praktikën e Referencave Doganore që përcaktohen nga dispozitat e Kodit Doganor. Eshhte ne te drejten dhe kompetencen e ISKSH, por dhe ne funksion te vendosjes se konkurrences se ndershme ne treg, që limite te tilla te jene te diferencuara, per farmacite qe jane subjekt i TVSH-se dhe per ato qe nuk jane subjekt i TVSH, apo qe farmacite se bashku me kërkesen e xhiros per rimbursim te paraqiten ne ISKSH dhe xhiroja totale të realizuar në muajin përkatës

-Përsa i përket pikës 3 të konstatimeve përsëri mendoj se kemi të bëjmë me një keqkuptim i cili vjen jo vetëm si rezultat dhe rrjedhojë logjike e pikës 2, por edhe si rezultat i thellimit në atë drejtim të cilin e gjykoj të gabuar. Plotësimi i limitit të caktuar nuk do të thotë aspak se farmacia nuk do të ofrojë shërbimin e dhënies së barnave të rimbursueshme dhe që në këtë aspekt kufizon sjelljen e konsumatorëve.

Farmacia fare mirë mund të vazhdojë shitjen edhe të këtyre barnave, por tashmë jo me cmimin e rimbursimit, por me cmimin real të tregut. Pra klienti nuk kufizohet aspak në zgjedhjen e tij.

Përfshirja në skemën e sigurimeve shëndetësore është një e drejtë dhe jo detyrim i subjektit që kërkon të përfshihet në të. Në të kundërt pala që nuk është dakord me kushtet parakontraktore mund të mos kërkojë të përfshihet në skemën e sigurimeve shëndetësore. Kjo klauzolë përcaktohet shumë qartë edhe në dispozitat e VKM Nr.85, datë 13.2.2003 “Për lidhjen e kontratave, ndërmjet ISKSH-së dhe farmacive, e depove të barnave”, VKM e cila është pjesë e legjislacionit specifik dhe ku tekstualisht përcaktohet:

“ISKSH, për mbulimin e një pjese të cmimit të barnave, lidh kontratë me depot e barnave dhe me farmacitë e rrjetit të hapur, të cilat shprehin interes për tu përfshirë në skemën e sigurimeve shëndetësore.”

Sa më sipër duke mos qenë dakord me vlerësimin e fakteve të bëra në pikat 2 dhe 3 të pjesës konstatuese të vendimit, hartuar nga shumica, nuk mund të jem dakord dhe të miratoj dhe dispozitivin e këtij vendimi i cili është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e atyre konstatimeve.

Prandaj cmoj që për pikat e mësipërme dhe dispozitivin e vendimit të jap votën kundër.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Koço BROKA



Anëtar